



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.01.2021, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rend i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II)”

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr. 62/2014”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha Gjerbrea, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Eglantina Gjermani, Ervin Bushati, Andrea Marto, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Ditmir Bushati, Halit Valteri, Fatmir Velaj, Ligoraq Karamelo dhe Reme Lala.

Mungon:

Rudina Hajdari.

Të ftuar:

Zef Mazi – Kryenegociator për Zhvillimin e Negociatave të Pranimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian

Ami Kozeli – Këshilltar i Kryenegociatorit

Dajna Sorensen – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Daniela Çekani – Drejtoreshë e Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA-s në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Nikolla Lera – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme të datës 22 janar të vitit 2021.

Në rendin e ditës kemi diskutimin e dy projektligjeve. Projektligji i parë lidhet me ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA II), për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe referon kolegja Gjebrea. Projektligji i dytë është “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr. 62/2014”, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Ervin Bushati.

Të ftuar për projektligjin e parë kemi zotin Mazi, kryenegociator për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian. Mirë se vjen, zoti Mazi! Kemi zonjën Sorensen, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë. Mirë se vjen, zonja Zëvendësministre! Kemi zotin Kozeli, këshilltar i Kryenegociatorit, por besoj dhe shpresoj të kemi edhe zonjën Daniela Çekani, drejtoreshë e Koordinimit të Programeve Kombëtare dhe Rajonale të IPA-s.

Mirë se vini, zotërinj!

Fillojmë pa humbur kohë.

Fjala është për ju, zoti Mazi.

Zef Mazi – Mirëmëngjesi!

Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, u uroj të gjithë anëtarëve të komisionit një vit të suksesshëm me shëndet dhe të gjitha të mirat!

Ju faleminderit për fjalën!

Faleminderit, zonja kryetare, që bëtë një spostim të rendit të ditës të parë që kisha parë! Arsyeja është se ka një përplasje në orën 11:00, ku unë kam mbledhjen e parë të këtij viti si Kryenegociator, janë të gjithë zëvendësministrat dhe do të më duhet të përfundoj te ju dhe të hyj në lidhje 5 minuta përpara orës 11:00 me grupin negociator.

Ju faleminderit edhe një herë për kujdesin!

Marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga ana e Këshillit të Ministrave nëpërmjet vendimit nr. 949, datë 02.12.2020, “Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit European në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit të asistencës së paraaderimit (IPA II) dhe është nënshkruar nga koordinatori kombëtar i IPA-s në datën 17.12.2020.

Programet vjetore kombëtare të IPA-s sanksionohen në rregulloren zbatuese të IPA II-shtit të Bashkimit European me nr. 447/2014 të datës 02.05.2014, si dhe në marrëveshjen kuadër mes Shqipërisë dhe Komisionit European “Për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërisë”, e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr. 37/2015, datë 09.04.2015. Kostoja totale e llogaritur e programit IPA 2019 është 71 milionë e 905 mijë euro dhe kontributi maksimal i Unionit në këtë program është vendosur në shifrën 70 milionë e 650 mijë euro. Ky program kërkon kontribut financiar nga përfituesi i fondeve IPA II, Shqipëria, në rastin konkret, dhe Bashkimi European.

Asistenca e IPA II është programuar për një periudhë shtatëvjeçare 2014-2022 dhe ka në fokus arritjen e objektivave të politikave sektoriale dhe rezultateve që janë të rëndësishme për anëtarësim. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me Komisionin European, është hartuar dokumenti indikativ kombëtar i viteve 2014 - 2020. Dokumenti strategjik përcakton prioritetet, asistencën financiare të BE-së për periudhën 2014-2020, për të mbështetur Shqipërinë drejt anëtarësimi tonë në BE, përcakton, gjithashtu, objektivat, identifikon aksionet dhe aktorët kryesorë, përshkruan rezultat e pritshme, tregon si do të matet dhe si do të monitorohet progresi, përcakton alokimet financiare, indikative.

Procesi programues për programin vjetor IPA 2019 ka nisur në muajin korrik të vitit 2018. Janë identifikuar prioritetet për mbështetje nga zyra mbështetëse e koordinatoreve kombëtarë të IPA-s, në bashkëpunim me zyrën e Kryeministrit, departamenti për zhvillim dhe mirëqenie dhe me delegacionin e Bashkimit European në Tiranë.

Gjatë konsultimeve u vendos që sektorët që do të merrnin mbështetje për IPA-2019 do të ishin arsimiti, punësimi dhe politikat sociale, nëpërmjet mbështetjes “BE për përfshirjen sociale”, si dhe mjedisi, përmes mbështetjes për sektorin e mjedisit duke u përqendruar në ekonominë qarkulluese. Si rezultat i procesit të programimit, zyra mbështetëse e koordinatorit kombëtar për IPA-n, në bashkëpunim me përfituesit, hartuan dy dokumente veprimi, si më lart. Në nëntor të vitit 2019 Komisioni European miratoi me vendim të posaçëm paketën e programit IPA 2019 me kosto prej 70 milionë e 650 mijë euro. Programi “BE për

mbështetjen sociale”, që do të zbatohet me një kosto prej 50 milionë eurosh. Programi “Mbështetje për ekonominë qarkulluese”, do të zbatohet me kosto 20 milion e 65 mijë euro.

Referuar situatës së krijuar nga tërmeti i nëntor 2019, si dhe pasojat e COVID -19, ndër të tjera, Komisioni Europian vendosi që të mbështesë Shqipërinë përmes rialokimit të fondeve IPA 2019. Më konkretisht, ia atashuam shumat e sipërpërmendura hartimit të propozimeve që do të lehtësonin pasojat ekonomike dhe sociale. Pra, programi IPA 2019 po zbatohet përmes veprimit “BE për përfshirjen sociale” që ka si objektive të përgjithshme të zgjerimit të mbulimit, gjithëpërfshirjes, efektivitetit dhe reagimit ndaj emergjencave të shërbimeve të kujdesit social, arsimit parauniversitar dhe mundësitë e punësimit për të rinjtë dhe të rriturit në Shqipëri, duke përfshirë popullatën në rrezik përjashtimi. Konkretisht, programi vjetor IPA 2019 do të zbatohet:

Së pari, nëpërmjet mbështetjes buxhetore prej 50,65 milionë euro me menaxhim direkt nga delegacioni i Bashkimit Europian, e cila është një shumë që do të kalojë në buxhetin e shtetit në bazë të përqindjes së realizimit të treguesve të kontratës së reformës sektoriale përkatëse. Objektivi i përgjithshëm i mbështetjes buxhetore është zgjerimi i mbulimit, gjithëpërfshirja, efektiviteti dhe përballimi i emergjencave të shërbimit të kujdesit social, arsimit parauniversitar dhe mundësitë e punësimit për të rinjtë dhe të rriturit në Shqipëri, duke përfshirë popullatat në rrezik përjashtimi.

Së dyti, nëpërmjet prokurimeve prej 8,7 milionë euro në menaxhim të drejtpërdrejtë nga delegacioni i Bashkimit Europian, ku pritet të lëshohen 3 ose më shumë procedura prokurimi për asistencë teknike për mbështetjen e institucioneve përgjegjëse, për përfshirjen sociale, për punësimin dhe arsimit parauniversitar.

Së treti, nëpërmjet granteve në menaxhim të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, ku dy milionë euro janë në menaxhim të tërthortë nga CFCU-ja dhe 9,3 milionë euro në menaxhim të drejtpërdrejtë nga delegacioni i Bashkimit Europian.

Për herë të parë, nga një program kombëtar IPA-ve, përfitues për grante do të jenë edhe bashkitë e përzgjedhura, ku janë 19 bashki, të cilat, në rast se do të jenë përfituese të granteve, janë të detyruara të paguajnë 10% të koston totale të grantit. Institucionet përfituese nga ky program janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Për herë të parë, nëpërmjet thirrjeve për propozime për grante, në një program vjetor IPA përfitues do të jenë bashkitë dhe shoqëria civile. Veprimi mbështet zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtje Sociale dhe Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe të Aftësisë.

Zonja kryetare, në mënyrë të përmbledhur, këto ishin pikat kryesore që unë kisha përfshirë në raport për komisionin tuaj.

Faleminderit!

Nëse keni pyetje tani, do të isha i kënaqur t'u përgjigjem, por në rast se keni pyetje më vonë, mund t'ju përgjigjet drejtoresha e Programit Kombëtar të IPA-ve të Ministrisë së Jashtme, zonja Daniela Cekani, dhe ndihmëskëshilltari i Kryenegociatorit, zoti Ami Kozeli, të cilët do të jenë të gatshëm t'i përgjigjen çdo pyetjeje që kanë anëtarët. Faleminderit!

Mimi Kodheli - Faleminderit, zoti Mazi!

Edhe unë ju uroj vit të mbarë dhe punë të mbarë në rolin dhe pozicionin tuaj kyç lidhur me një proces kaq të rëndësishëm, siç është hapja e negociatave për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Zonja Sorensen, a keni diçka për të shtuar, përpara se t'ia jap fjalën relatores, koleges Gjebrea?

Dajna Sorensen – Jo, nuk kam ndonjë element shtesë në lidhje me këtë marrëveshje. Ne jemi një prej përfituesve nga ky program, pra një nga ministritë përfituese të këtij programi. Ne vijmë pas një eksperiencë shumë pozitive me mbështetjen buxhetore të kontratës IPA 2015, e cila ka qenë shumë e suksesshme dhe ne kemi arritur të thithim mbi 86% të fondeve të mbështetjes buxhetore.. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Fjalën e ka kolegia Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

I nderuar zoti Mazi,

E nderuar zonja Sorensen,

Të nderuar përfaqësues të ministrive përkatëse,

Ashtu sikurse edhe zoti Mazi tha, sot kalojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Bashkimit Europian në lidhje me programin vjetor kombëtar për Shqipërinë për vitin 2019, në kuadër të instrumentit për IPA II”, propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Së pari, dua të theksoj bazën kushtetuese të projektligjit. Ai është në përputhje me nenet 81, pika 1, dhe 100 të Kushtetutës për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë dhe ligjin 2015 “Për ratifikimin e marrëveshjet kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Europian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për IPA II”.

Në fakt, zoti Mazi e përmendi me detaje se cili është thelbi i kësaj marrëveshje që vjen sot. Dua ta theksoj edhe një herë pjesën e forcimit të marrëveshjes sociale. Po ashtu, programi përkrah popullsinë në risk varfërie dhe të përjashtuarit socialë, duke përfshirë meshkujt, burrat, gratë në risk, njerëzit me paaftësi fizike dhe minoritetet.

Po ashtu, vlen të theksohet se ky program vjetor i veprimit mbështet zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale, e cila ka një sërë objektivash brenda saj.

Programi vjetor i veprimit e mbështet mundësinë e punësimit dhe krijimit të vendeve të punës përmes modeleve të reja të dhënies së shërbimeve, prezantimit të programeve të reja për punësimin dhe shpërndarjen e programit të mirëqenies në punë. Besoj se është shumë e rëndësishme që të kemi rezultate në lidhje me të.

Për sa u përket efekteve financiare, të cilat përmendën nga zoti Mazi, kostoja totale e llogaritur e këtij programi është 71 milionë dhe kontributi maksimal i Bashkimit European është rreth 70 milionë.

Së fundi, duke përmendur të gjitha avantazhet dhe gjitha benefitet që kemi nga projektet IPA, disa pika të dobëta, të cilat janë përmendur vazhdimisht, në dijeninë time, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Europën i ka adresuar, por, pa dyshim, që kërkojnë një vëmendje më të madhe, si pjesa e mungesës së kapaciteteve financiare dhe burimeve njerëzore për zbatimin e projekteve nga ana e përfituesve të institucione publike, pra problematika të cilat i janë parashtruar edhe Ministrisë Financave dhe Ekonomisë. Unë di që është propozuar ngritja e një fondi kombëtar bashkëfinancimi për mbulimin e të gjithë bashkëfinancimit të përfituesve shqiptarë, që zbatojnë projekte të financuara nga programi i bashkëpunimit territorial, për të mundësuar likuiditetin financiar të projekteve. Nuk e di nëse zonja Sorensen mund të na thotë diçka në lidhje me këtë. Unë e gjykoj si shumë të rëndësishëm dhe me avantazh sugjerimin për ngritjen e këtij fondi kombëtar.

Nga ana tjetër, për problematikat që janë raportuar nga Ministria e Jashtme, nuk dua të futem në detaje, di që janë marrë masa, si: çështja e hapjes së llogarive apo të transfertës së transheve dhe problemet me rimbursimin e TVSH-së. Por mendoj se është shumë i rëndësishëm raportimi disa herë i tyre, pra mospasja e rezultateve të dukshme të projekteve, duke pasur parasysh që projektet orientohen drejt studimeve apo trajnimeve, që ndoshta sjell edhe mospasje të rezultateve shumë të qëndrueshme, pavarësisht se shumë rezultate janë arritur dhe benefitet për sa u përket projekteve ...

Mimi Kodheli – Shikoj që zonja Gjebrea ka një problem me internetin. Zonja Gjebrea, nuk dëgjoheni.

Zoti Mazi, kurdo që ta mendoni jeni i lirë të largoheni.

Faleminderit, për prezencën!

Elona Gjebrea – ... dhe Bashkimi European për kontributin maksimal që i jep Shqipërisë në mbështetjen e projekteve IPA.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zoti Mazi.

Zef Mazi – Ju falënderoj, zonja kryetare!

A mund t'ju marr edhe dy minuta kohë që të jap një sqarim?

Mimi Kodheli – Me shumë kënaqësi.

Zef Mazi – Kjo që po ju them meriton edhe një pyetje.

Unë përmenda faktin që janë përzgjedhur shumë bashki, por si janë përzgjedhur dhe përse janë përzgjedhur këto bashki? Ju njoftoj si komision, se rastet e vetme kur bashkitë mund të jenë përfituese nga fondet e grantit të këtij programi janë ato që synojnë të përmirësojnë dhe të rrisin nivelin e shërbimeve dhe partneriteteve të qeverisjes vendore. Granti do të jetë i hapur për 19 bashki, të cilat janë: Bashkia e Përrenjasit, Bashkia e Gjirokastrës, Bashkia e Vlorës, Bashkia e Mallakastrës, Bashkia e Cërrikut, Bashkia e Librazhdit, Bashkia e Shijakut, Bashkia e Kavajës, Bashkia e Kurbinit, Bashkia e Kukësit, Bashkia e Krujës, Bashkia e Pogradecit, Bashkia e Korçës, Bashkia e Kamzës, Bashkia e Vlorës, Bashkia e Shkodrës, Bashkia e Elbasanit, Bashkia e Durrësit dhe Bashkia e Tiranës. Këto bashki janë përzgjedhur nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me delegacionin e Bashkimit European mbi bazën e disa kriterëve, që lidhen me shkallën e varfërisë, kërkesën për punësim, kriterin demografik, strukturën e ekonomisë lokale dhe nivelin e dhënies së shërbimeve.

Përfituesit e projektit IPA 2, e përmenda edhe në raportin e parë, janë të detyruar të financojnë 10% të kostos së grantit ku do të jenë përfitues. Në këtë kontekst, duke qenë se edhe bashkitë janë përfituese nga këto grante, do të duhet të sigurojnë 10% të fondeve të grantit nga buxheti i tyre. Aktualisht nuk është e përcaktuar kostoja që është detyrim i shtetit tonë. Ky përcaktim do të bëhet pasi të kryhen procedurat e njoftimit të thirrjeve për propozime dhe të përcaktohen edhe bashkitë fituese të grantit. Ky është një informacion plus që ma merr mendja se është në interesin e komisionit për ta ditur.

Zonja kryetare, më falni që më duhet të largohem më parë.

Mimi Kodheli – Në rregull!

Punë të mbarë!

Zef Mazi – Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zëvendësministrja Sorensen, na thoni diçka lidhur me atë që kërkoi kolegja Gjebrea prej jush.

Dajna Sorensen – Pjesën financiare unë do ta sjell me shkrim, pasi është një fushë të cilën nuk e mbuloj.

Për sa i përket natyrës së projekteve, unë do të doja të nënvizoja këtu një projekt. Në 70 plus milionë, që zoti Mazi i përmendi, mbi 50 milionë janë mbështetje buxhetore. Kjo mbështetje buxhetore vjen drejtpërdrejtë nga buxheti i shtetit dhe përfitohet falë realizimit të indikatorëve të dakordësuar paraprakisht që janë të përfshirë në këtë marrëveshje. Domethënë, shteti shqiptar merr një angazhim për realizimin e disa objektivave konkretë. Në këtë rast qoftë në fushën e mbrojtjes sociale, qoftë në fushën e arsimit, të punësimit apo të arsimit profesional, vetëm nëse këto objektiva arrihen, përfitohet ndihma ose mbështetja buxhetore financiare në rastin konkret. Pjesa tjetër janë një kombinim grantesh që u kalojnë bashkive, siç e përmendi zoti Mazi, por edhe mbështetje teknike. Megjithatë, dua të nënvizoj që më e rëndësishme është se shumica e këtyre fondeve janë mbështetje e mirëfilltë buxhetore, thjesht duhet të kemi parasysh që t'i parashikojmë këto fonde paraprakisht, të arrijmë ata objektiv të vendosura dhe më pas të marrim frytet nga Bashkimi European. Sikurse unë e përmenda edhe më parë, ne kemi një eksperiencë shumë pozitive për sa i përket thithjes së fondeve buxhetore, në rastin konkret për kontratën që ka pasur të bëjë me punësimin ajo ka pasur një absorbim të fondeve në masën gati 87%. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, Zëvendësministre!

Kam një kërkesë, para se t'ua jap fjalën kolegëve për pyetje apo diskutime.

Së pari, dua miqësisht t'ju tërheq vëmendjen dhe kërktoj nga ju që të mundësoni një përgjigje ndaj kolegëve, sepse dihen arsyet dhe natyra e pyetjeve. Unë nuk do të doja kurrë që çdokush, i cili ka ardhur sot për të diskutuar për projektligjin, të thotë që nuk e mbulon këtë fushë. Kjo gjë nuk duhet të diskutohet fare, sepse ju jeni atje për të mbuluar fushën dhe, në qoftë se ju nuk e mbuloni këtë fushë apo këtë projektligj, atëherë le të vijë dikush tjetër që e bën këtë gjë.

Së dyti, ka disa gjëra që nuk janë të nevojshme të përsëriten, pasi ne kemi kaluar kaq shumë projektligje që lidhen me projektet IPA, nuk është e nevojshme të biem në ripërsëritje, do të doja që të fokusoheshit vetëm te specifikat e kësaj marrëveshjeje. Kjo është shumë miqësore dhe shumë shoqërore.

Unë do të doja të përgjigjeshit në kohë, sa herë që kërkohet të jeni prezent këtu, sepse vërej, gjë që e kam diskutuar edhe me ministren, se nuk përgjigjeni në kohë. Miqësisht ju kërktoj të përgjigjeni dhe të jeni të përgatitur, brenda mundësive sigurisht, se mund të keni

edhe pyetje ekstra, që duhet patjetër t'u përgjigjeni pyetjeve me shkrim, por t'u mundësoni kolegëve një përgjigje të saktë kur flasim për gjëra specifike.

Duhet të njoftoj kolegët që në *email*-et e tyre kanë një raport të detajuar të nisur mbrëmë të çdo gjëje që ka lidhje me projektin IPA dhe me çfarë është bërë deri sot lidhur me zbatueshmërinë dhe përfitimet që kanë ardhur nga ratifikimi i marrëveshjeve ndërmjet qeverisë së Shqipërisë dhe Komisionit të BE-së.

Kush e do fjalën.

Zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Faleminderit!

Së pari, dua të falënderoj zyrën e ambasadorit Mazi për dërgimin e informacioneve që ne kishim kërkuar. Por, mundësisht do të doja që, besoj se edhe kolegët e tjerë të jenë dakord, kur dërgojmë materiale të tilla, të cilat na duhen për mbledhjet, të dërgohen pak më përpara. Domethënë, ne duhet të insistojmë që institucionet relevante t'u përgjigjen me përpikëri dhe seriozitet kërkesave të Komisionit të Jashtëm, për më tepër kur bëhet fjalë për mënyrën si janë menaxhuar fondet IPA.

Për zëvendësministren kisha vetëm një pyetje, nëse nuk është në gjendje të përgjigjet, mjafton të thotë se nuk është fusha që mbulon. Unë kam një shqetësim, të cilin besoj edhe kolegët e tjerë e ndajnë prej shumë vitesh sa i përket efikasitet dhe impaktit që fondet IPA kanë në Shqipëri.

Zëvendësministrja Sorensen foli për mbështetjen ndaj mbrojtjes sociale, e cila është inekzistente. Ju folët për shumë fusha të tjera që mbështeten nga fondet IPA, të cilat janë në nivele skandaloze krahasuar jo vetëm me vendet anëtare të BE-së, por edhe me vendet e tjera të rajonit. Ne kemi kapacitet shumë të ulët të përthithjes jo vetëm të fondeve, por edhe të ekspertizës evropiane dhe të implementimit të projekteve, të mbështetura nga paratë e taksapaguesve evropiane këtu në Shqipëri. Rezultati ulërit se në çdo skaj të Shqipërisë dhe situata është skandaloze, në mënyrën si këto fonde keqpërdoren ose ndoshta përvetësohen nga duar të fshehta të lidhura me segmente të caktuara të pushtetit. Unë nuk e kam vetëm për këtë qeveri sot, e kam në vite, ndaj, a ka një mekanizëm për të parë se si implementohen këto fonde? Ku shkojnë këto fonde? Çfarë impakti kanë në shoqërinë tonë përtej propagandës ideologjike të tipit: mbështetës i mbrojtjes sociale, mbështetës i bashkive po mbështetës i infrastrukturës e të tjera?

Ky është një shqetësim që unë e kam pasur vazhdimisht dhe për këtë arsye ne duhet ta ngremë zërin këtu në Komisionin e Jashtëm.

Faleminderit, zonja kryetare!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Gjoni!

Para se t'ia jap fjalën koleges Gjebrea, më lejoni të bëj një koment.

E para, zoti Gjoni, komenti juaj është thellësisht politik dhe aspak teknik. Unë e mendoj dhe e gjykoj këtë gjë kështu, prandaj ju ftoj ta lexoni raportin që ju ka ardhur mbrëmë, sepse aty do të gjeni përgjigjet e të gjitha shqetësimeve që ju ngrini, shqetësime që ishin opinionet tuaja, por jo të bazuara në shifra. Nuk mendoj t'ia jap fjalën zëvendësministres, pasi ato kishte për të na i thënë zëvendësministrja na i tha.

Sa i takon asaj që kemi arritur deri më sot në raport me zbatimin e marrëveshjes së financimit IPA II, për të cilën jemi duke folur, pasi të gjithë ta lexojnë me vëmendje raportin që ka ardhur mbrëmë, besoj se do të jemi pak më të ndriçuar.

Kolegë, nga ana tjetër, do t'ju ftoja që të mos paragjykoni kur pyesni, qoftë kolegët tuaj, qofshin këta zëvendësministra apo ekspertë që vijnë këtu, si po e bëj pyetjen, por nuk e di nëse do të jetë në gjendje të më japë përgjigje. Sa i takon kësaj çështjeje, ne nuk mund ta dimë nëse do të jenë në gjendje të na japin përgjigje ose jo. Unë besoj se jo niveli i zëvendësministres Sorensen, por edhe shumë më poshtë se ky nivel do të ishin në gjendje fare mirë të na jepnin përgjigje se ku jemi deri më sot me zbatimin e marrëveshjes për të cilën jemi duke folur.

Fjala e ka kolegia Gjebrea.

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, dëshiroj t'ju them diçka edhe në përgjigje të asaj që tha zoti Gjoni.

Së pari, Bashkimi European ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm sa u përket përpjekjeve të Shqipërisë në rrugën drejt anëtarësimit. Po ashtu, edhe fondet IPA kanë dhënë kontribut të rëndësishëm për të përmirësuar shumë aspekte dhe standarde të jetesës në vend dhe asistenca është dhënë në mënyrë shumë transparente nëpërmjet modaliteteve të ndryshme. Kam respekt maksimal për zonjën Sorensen, për zotin Mazi, pasi ata janë ekspertët e duhur dhe shumë profesionalë sa u takon fushave që ata mbulojnë dhe pa dyshim që dinë të adresojnë të gjitha problematikat që kanë.

Në raportin që na ka ardhur nga Ministria e Jashtme ka informacion të mjaftueshëm sa i përket progresit që ka bërë Shqipëria. Nuk janë pak, por janë 9 përgjigje strategjike sektoriale në kuadër të programimit IPA II dhe III të konsoliduara në përgjigje të përgjithshme strategjike.

Unë i konsideroj si një mundësi shumë të mirë, siç jua thashë edhe në fjalën time, projektet IPA, por sigurisht problematika të caktuara që unë i theksova kanë neve të adresohen. Jam e bindur se stafet përkatëse të ministrive janë në gjendje t'i adresojnë të gjitha

problematikat, sidomos ato problematika që janë të pranishme në momentet kur kemi të bëjmë me projekte, aq më shumë për ato që janë projekte në partneritet me institucionet e tjera dhe me shtete të tjera, që kërkojnë edhe përgatitje të kapaciteteve njerëzore, edhe atyre logjistike.

Jam shumë optimiste dhe i ftoj të gjithë kolegët ta miratojnë këtë marrëveshje, që ka ardhur sot në Komisionin e Politikës së Jashtme.

Faleminderit, zonja kryetare!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegja Gjebrea, në ndihmë të diskutimit dhe të sqarimit të pikëpyetjeve të mëdha që na lindin ne, si kolegë deputetë!

Zoti Gjoni, fjala për ju.

Ralf Gjoni – Faleminderit, kryetare!

Në fakt, komenti im ishte shumë teknik, nuk ishte aspak politik, sepse unë jam këtu si përfaqësues i një partie politike apo i një axhende politike, thjesht po ushtroj rolin tim si deputet. Nuk e paragjykoj aspak zëvendësministren, me zonjën Sorensen njihemi prej vitesh dhe nuk kam asnjë opinion negativ, përkundrazi.

Dua t'ju ftoj ta tërhiqni atë që thatë, sepse ma tjetërsuat...

Mimi Kodheli – Zëvendësministria nuk është në provim këtu, se nuk ka paraqitur CV-në dhe të vërtetojmë sa e zonja është apo jo.

Opinionin juaj ishte i pabazuar në shifra dhe të dhëna. Diskutimin bëje politik sa të duash, por largohu nga diskutimi dhe komentet për zëvendësministren.

Ralf Gjoni - Edhe një herë, zonja zëvendësministre, nuk e kisha aspak me ju. Ajo që doja të thosha është se, në qoftë se kjo nuk është pjesë e fushës që ju mbulon në dikasterin tuaj, ne mund ta realizojmë këtë edhe përmes një shkëmbimi me shkrim.

Jam shumë mirënjohës për informacionin që na ka ardhur nga ministria, por sërish besoj se ka vend për të ngritur shqetësime dhe për të kërkuar informacion sa i përket mënyrës se si implementohen fondet IPA në Shqipëri.

Mimi Kodheli - Nëse nuk keni gjë tjetër, zoti Gjoni, atëherë mos bini në përsëritje.

Ralf Gjoni – Unë kërkoja si deputet që zëvendësministria të më përgjigjet nëse është parashikuar një mekanizëm efikas për të evaluuar mënyrën se si implementohen këto fonde dhe efikasitetin e zbatimit të këtyre fondeve.

Faleminderit!

Dajna Sorensen – Do të doja të shpjegoja dy elemente. Elementi i parë ka të bëjë me përfaqësimin tim sot në këtë komision. Unë këtu jam si përfaqësuese e përfituesve të këtij programi, nuk jam në kapacitetin e njësisë që monitoron programet IPA.

Megjithatë, konkretisht në lidhje me pyetjen që kishte zoti Gjoni, sikurse ka të paktën 4 vjet që njihem unë në lidhje me programet IPA dhe mbështetjen buxhetore sektoriale, ka misione monitorimi të pavarura nga Bashkimi Europian, që vijnë çdo 6 muaj në Shqipëri dhe bëjnë një vlerësim të detajuar si të zbatimit të programit në vetvete, ashtu edhe të arritjes së indikatorëve, për të cilët raportojmë çdo vit para se të jemi në gjendje të marrim, domethënë ka një kontratë të veçantë, që e lidh direkt BE-ja, për monitorimin çdo 6 muaj të zbatueshmërisë së programit IPA në këtë rast.

Për më tepër, ne kemi edhe disa struktura që ekzistojnë për të monitoruar në mënyrë periodike, sikurse kemi edhe nënkomitetet e ndryshme ku ne, gjithashtu, raportojmë për arritjet që kemi në lidhje me zbatimin e kontratave IPA.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zëvendësministre!

E hedhim në votim.

Kush është dakord me projektligjin?

Faleminderit!

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

E konsideroj të miratuar 100%.

Neni 1.

Jemi të gjithë dakord.

Faleminderit!

Neni 2.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit!

Votojmë në tërësi ligjin.

Faleminderit, zoti Shameti!

Faleminderit, zotërinj!

Faleminderit, zëvendësministre për prezencën!

Halit Valteri – Edhe unë jam pro, zonja kryetare!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Valteri!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.01.2021, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rend i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr. 62/2014”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha Gjerbrea, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Eglantina Gjermani, Ervin Bushati, Andrea Marto, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Ditmir Bushati, Halit Valteri, Fatmir Velaj, Ligoraq Karamelo dhe Reme Lala.

Mungon:

Të ftuar:

Nikolla Lera – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Mimi Kodheli – Kalojmë në projektligjin “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin për parandalimin e evazionit fiskal, ratifikuar me ligjin nr. 62/2014”.

Jemi komision për dhënie mendimi. Relator është kolegu Ervin Bushati.

Kemi prezente zonjën Vjero, zëvendësministre në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe zotën Lera, drejtor në këtë ministri.

Mirë se vini!

Zonja Vjero, urdhëroni!

Nikolla Lera – Zonjë kryetare,

Zonja Vjero ishte në një mbledhje të rëndësishme në Këshillin e Ministrave, kështu që, në lidhje me këtë protokoll ndryshues, më autorizoi mua që të sqaroj komisionin tuaj të nderuar.

Mimi Kodheli – Dakord.

Urdhëroni, zoti Lera!

Nikolla Lera – Shqipëria dhe Kosova kanë nënshkruar dhe kanë ratifikuar marrëveshjen për linjën e tatimit të dyfishtë që në vitin 2014. Në vitin 2020, gusht-shtator, pala kosovare propozoi axhustimin e kësaj marrëveshjeje, të ratifikuar në vitin 2014, për disa elementë apo për disa lloje të ardhurash për ta ndarë në mënyrë më të ndershme të drejtën e taksimit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Konkretisht, u analizua dhe u diskutua taksa për dividendin, e cila ishte e papërcaktuar në marrëveshjen e vitit 2014 dhe pas negociatave të dyja palët me konsensus vendosën që tatimi për dividendin të mbahet në burim 5% për pjesëmarrjet mbi 25% dhe 8% për pjesëmarrjet nën 25%. Çfarë do të thotë kjo?! Nëse një seli e përhershme në Shqipëri, por që zotërohet nga një person juridik, nga një entitet apo nga një individ në Kosovë, do të shpërndajë dividend në Shqipëri, atëherë Shqipëria, si vend burimi, do të mbajë 5% tatim mbi dividendin. Anasjelltas kjo do të ndodhë edhe në Kosovë, nëse pjesëmarrja është mbi 25%, gjithmonë. Nëse është nën 25%, taksa që do të mbahet në burim për llogari të dividendit në Shqipëri apo në Kosovë do të jetë 8%.

Po kështu, u saktësua edhe ndarja e të drejtës së taksimit për të drejtën e pronësisë, ato që quhen *royalties*, ku u përcaktua që vendi i burimit, vendi që bën pagesën, do ta mbajë taksën 10% në burim. Këto janë ndarjet e drejta të taksimit, standarde që përdoren në marrëveshje në çdo vend, nuk ishin përcaktuar me Kosovën, u saktësuan, sikurse e thashë, me kërkesën e tyre dhe me aprovimin tonë. Krahas këtyre dy elementeve që ndanë të drejtën e taksimit, u bënë edhe disa plotësime të tjera, sepse nga viti 2014, kur ishte ratifikuar

marrëveshja e parë deri në vitin 20120, kanë ndodhur shumë ngjarje të rëndësishme në fushën e luftës kundër evazionit fiskal. Po përmend këtu marrëveshjen BEPS *Base Erosion and Profit Shifting*, që është një iniciativë e gjithanshme dhe, në kuadër të saj, ne dhe Kosova përfshijmë në marrëveshje edhe terminologjinë që lidhet me të, standardet minimale ndërkombëtare që janë të detyrueshme për t'u ndjekur, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me terminologjinë e tekstit dhe të modeleve, sipas modelit të UN-së apo të OECD-së. Dy problemet e fundit janë probleme teknike. Dy problemet e para që thashë: ndarja e të drejtës së taksimit për taksën mbi dividendin dhe për *royaltie* ishin çështjet më kryesore. Pra, e gjitha që doja të thosha ishin këto 4 elemente që u ringociuan me palën kosovare dhe konform të gjithë procedurës ligjore të miratimit në Këshillin e Ministrave. Pasi janë zhvilluar diskutimet dhe, pasi është rënë dakord, po prezantohen sot në komisionin tuaj të nderuar për miratim.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Lera!

Kolegu Bushati.

Ervin Bushati – Zonja kryetare, faleminderit!

Faleminderit, kolegë!

Më vjen mirë që takimi ynë i Komisionit të Jashtëm me Komisionin e Jashtëm në Prishtinë më 8 dhjetor mes të gjitha diskutimeve që kishim, patjetër që janë edhe disa projektligje, të cilat ndihmojnë integrimin e ekonomive, e pse jo dhe të shoqërive ndërmjet vendeve tona vëllezër, jo thjesht marrëdhënie miqësore. Prandaj, me të drejtë ndjehemi mirë sot, kur miratojmë një projektligj të tillë, që e kemi edhe me shumë shtete të tjera, ligj për të cilin kishte ardhur koha, e ndoshta duhej ta kishim bërë edhe më parë, por më mirë vonë se kurrë. Në vazhden e bisedave që patëm, por edhe të kërkesave e të rakordimit të axhendave me Komisionin e Jashtëm, bashkë në Prishtinë, në takimin e datës 8 dhjetor, të kemi këtë projektligj. Unë mendoj se kjo është një arritje, është një detyrim që kishim. Patjetër, uroj që të hyjë sa më shpejt në praktikë dhe të votohet në unanimitet nga të gjithë deputetët, si të maxhorancës, ashtu edhe të opozitës, sidomos kur bie fjala për zhvillimin ekonomik, në një moment kaq të vështirë, por kur kemi të bëjmë me një shtet e me një komb vëlla, siç është shteti i Kosovës, që e kemi të domosdoshme këtë marrëveshje, unë mendoj se duhet të ecim edhe me shumë marrëveshje të tjera, të cilat integrojnë, unifikojnë dhe heqin diferencën ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Bushati!

Në fakt, thjesht dua të riformoj atë që ju sapo thatë, që pikërisht ky projektligj i favorizon dhe stimulon shumë marrëdhëniet midis dy vendeve tona, qoftë për sa i përket shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit, parandalimit të evazionit fiskal, lehtësimit që krijon pikërisht ndryshimi i ligjit ekzistues.

Mirë. Kalojmë në pyetje e diskutime, nëse ka.

Në fakt, unë e falënderoj zotin Lera për saktësinë me të cilën e prezantoi këtë projektligj dhe për të qenit vërtet shterues, duke u shkëputur nga tekniku i mirë për të cilin unë e njoh, ndaj ju ftoj që thjesht e vetëm ta miratojmë këtë projektligj, ratifikimin e një protokollit, i cili me të vërtetë thjeshtëson, favorizon dhe stimulon marrëdhënien ekonomiko-tregtare midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Falënderoj edhe kolegun Bushati për nxjerrjen në pah të faktit se ky është një diskutim që e kemi bërë edhe gjatë vizitës që komisioni ynë ka pasur me kolegët tanë kosovarë pak javë më parë.

Shikoj që nuk ka komente. Atëherë, me lejen tuaj, e kalojmë projektligjin në votim. Kush është dakord me ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes?

Shoh që të gjithë kolegët janë dakord! Ju faleminderit!

Neni 1?

Neni 2?

Kundër? Abstenim? Nuk ka. Shoh që jemi të gjithë dakord.

Edhe një herë ju lutem, e hedhin projektligjin për votim në tërësi.

Mirë, kolegë, ju falënderoj për bashkëpunimin, ju falënderoj për votimin e njëzëshëm. Besoj se bashkë do të shihemi javën tjetër, mbase për të diskutuar projektligjin e radhës.

Faleminderit! Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

